

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA -SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	02.03.2020			
					
		Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numrit Broj Number	Shitojca Priica Appendix	Vlera Vrednost Value
		01	351	13450	7

KONTRATË

KOMUNA SUHAREKË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), te cilën e përfaqëson **Bujar Kuçi** shëf i zyres së prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA¹dhe në PMK² nga njësia e kërkesës, në njërën anë dhe:

N.T.SH "ELTONI", me seli në Suharekë me nr të biznesit 70418532, te cilën e përfaqëson **Hilmi Berisha** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli i kontratës

Shërbimet e parkingut për automjetet e zyrtareve Komunal
 Nr.prokurimit: 624- 20-004-235/624-20-103-235

Neni1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Shërbimet e parkingut për automjetet e zyrtareve komunal, sipas specifikimit të detyrueshme të dhëna me dosje të tenderit.
- 1.2 Kontrata është një vjeçare (1) dhe hynë në fuqi me: 02/03/2020 dhe përfundon me 28/02/2021.
- 1.3 Vendi i kryerjes së shërbimit është parkingu i OE në Suharekë.
- 1.4 Incotermii aplikueshëm do të jetëDDP³(Detyra e Dërguar e Paguar).
- 1.5 Kontrata menaxhohet nga njësia e kërkesës, drejtoria e administratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

¹ZKA ZyrtariKryesorAdministrativ

²PMK Plani për Menaxhimin e Kontrates

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4.800,00 € (katërmijë e tetëqind euro)**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro nga njësia e kërkesës. Autoriteti Kontraktues do të lejoj pagesat mujore në vlerë prej 400,00 euro (Katërqind euro mujore, ku operatori ekonomik duhet të sjellë faturën për kryerje të shërbimeve me raportin e nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës për automjete dhe menaxheri i kontratës nga njësia e kërkesës në llogarinë bankare të OE.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **shërbimeve** duhet të jetë i plotë në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 365 ditë, pas pranimit të **shërbimeve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin: *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat/të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet/[te kryej ndonjë ose të gjitha punët* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar

me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë vendim nga gjykata kompetente në Kosovë.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **gjykatën kompetentë në pajtim me ligjin e Kosovës**.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrine identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqipe] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Kontakt numri i Operatorit ekonomik: **044-473599**

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues


Emri:	Hilmi Berisha	Emri:	Bujar Kuçi
Pozita:	Përfaqësues	Pozita:	Shef i zyrës së prokurimit
Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Data:	02.03.2020	Data:	02.03.2020
Vula:		Vula:	

Titulli: SHERBIMET E PARKINGUT PER AUTOMJETET E ZYRTAREVE KOMUNAL

Me nr te prokurimit 624-20-004-235 & 624-20-103-2-3-5

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

SPECIFIKIMET E DETYRUESHME TEKNIKE					
Artikull	Specifications	Njesia	Sasia	Çmimi	SHUMA
1	Sherbime te parkingut per automjetet e zyrtareve komunal sipas specifikimeve teknike ne aneks 1 te kesaj dosje	MUAJ	12	400	4800

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i OE:	NTSH ELTONI
Adresa e plotë:	Suhareke
Përfaqësuar nga:	
Emri	Hilmi Berisha
Pozita	Pronar
Nënshkrimi	
Data	24.02.2020
Vula	